

## AKTI I THEMELIMIT

### “R & R SHPK.”

Në mbështetje të ligjit 9901 datë 14.04.2008, “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare” i ndryshuar, hartohet ky Akt Themelimi për themelimin e shoqërisë **R & R SHPK**.

#### Neni 1

##### Emërtimi dhe Themelimi

1. Emri Shoqërisë është **“R & R” SH.P.K**
2. Shoqëria ka formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar.
3. Ortak i vetëm, themelues i shoqërisë është **Ilir REKA**
4. Data e themelimit është **19.03.2021**.

#### Neni 2

##### Objekti

1. Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:  
Import dhe eksport, instalim, mirëmbajtje, tregti me pakicë dhe shumicë të paisjeve kompjuterike, kancelarike, telefonike, elektronike, mekanike, të telekomunikacionit, elektrike etj. Të ideojë, zbatojë dhe të menaxhojë rrjete të telekomunikacionit dhe transmetimit të të dhënave dhe interkoneksionet në përgjithësi. Të plotësojë nevojat industriale, tregtare, sociale dhe të rezidentëve për shërbime telekomunikacioni gjithëpërfshirës dhe efektiv. Të kënaqë të gjithë kërkesat praktike dhe të arsyeshme për këto shërbime. Të sigurojë shërbime konsulence, këshillimi, supervizimi, trajnimi dhe kontrata shërbimi. Të interkonjektohet me ofrues të tjerë shërbimesh dhe shoqëri të telekomunikacionit për të furnizuar shërbime end-to-end. Të kryej cdo transaksion lidhur me pasuritë e luajtshme dhe me pasuri të paluajtshme si edhe cdo aktivitete tregtare financiare dhënie me qera ose lënie peng i cili mund të konsiderohet si i dobishëm dhe i nevojshëm. Të blejë direkt ose indirekt interesa në shoqëri të tjera të cilat kanë një qëllim të njëjtë me atë të shoqërisë në Shqipëri ose jashtë saj. Të kryejë cdo gjë që shoqërisë i duket e nevojshme e leverdishme ose e rastësishëm për të arritur qëllimin e saj. Shërbime informatike dhe telefonike, shpërndarje internet dhe konektivitet. Krijim dhe shpërndarje programe kompjuterike. Konsulencë teknike dhe riparim paisje kompjuterike dhe elektronike. Tregtim, import dhe eksport, instalim, mirëmbajtje dhe tregtim i sistemeve të fonisë, sistemeve të alarmit kundra vjedhjes, sistemeve të alarmit kundra zjarrit, sistemeve të kamerave të survejimit dhe vëzhgimit CCTV, sistemeve të akses kontrollit, sistemeve aparaturash mjeksore, sistemeve UPS, stabilizatorët, gjeneratorët, radio



ndërlidhje, sistemeve me fibër optike, sistemeve autovizive etj. Programim software, ushtrimi i aktivitetit në fushën e teknologjisë së informacionit, veçanërisht në ndërtimin, tregtimin dhe reklamimit të faqeve të internetit dhe/ose çdo aktiviteti tjetër tregtar në këtë fushë. Ushtrimin e aktivitetit të konsulencës në fusha të ndryshme ligjore, sociale, historike dhe/ose të cdo natyre tjetër, sipas rastit. Çdo aktivitet tjetër tregtar dhe biznesi i cili lejohet nga legjislacioni shqiptar i zbatueshëm e në fuqi.

### **Neni 3 Kohëzgjatja**

1. Kohëzgjatja e Shoqërisë do të jetë pa afat të caktuar. Ky afat mund të ndryshohet një ose më shumë herë me vendim të Ortakut të Vetëm të shoqërisë.

### **Neni 4 Selia**

1. Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Njësia Bashkiake Nr.8- Tiranë, Rruga “4 Dëshmorët”, Apartamenti 17, Kodë Postar 1017.

### **Neni 5 Kapitali**

1. Kapitali i shoqërisë është 100,000 (njëqind mijë)lekë, dhe është i ndarë në 1 kuotë dhe vlera nominale e një kuote është 100,000 (njëqind mijë) lekë. Ortaku i Vetëm është zotëruesi i të gjithë kuotave të shoqërisë, në vlerën 100% të tyre.

### **Neni 6 Organet e Shoqërisë**

1. Organet drejtuese të shoqërisë janë:
  - a. Ortaku i Vetëm
  - b. Administratori

### **Neni 7 Ortaku i vetëm**

1. Ortaku i Vetëm i shoqërisë ushtron kompetencat që ligji i jep Asamblesë së Ortakëve.
2. Ortaku i Vetëm i shoqërisë është **Z.Illir REKA**.



**Neni 8  
Administratori**

1. Administrator i Shoqërisë është **Z.Illir REKA**.

**Neni 10  
Shpenzimet e themelimit**

1. Shpenzimet për hartimin dhe nënshkrimin e këtij Akti Themelimi ashtu si dhe te gjitha shpenzimet për njohjen ligjore dhe rregjistrimin e Shoqërisë janë në ngarkim të kësaj të fundit.

**Ortaku i Vetëm, Themeluesi**

**Ilir REKA**

*Ilir Reka*  
